

Turqia i ka thënë “PO” shamisë në shkollë dhe “jo” makijazhit dhe tatuazheve në këto ambiente.

Qeveria e Ankarasë ka publikuar një dekret më 27 shtator, duke saktësuar se cilat do të jenë rregullat e reja të cilat do tu nënshtrohen fëmijët e moshës 10 vjeç e lartë në shkolla. Lajmi është bërë i ditur nga Hurriyet online.

Të gjithë studentët, si femrat dhe meshkujt, nuk mund të lyejnë flokët, të bëjnë makijazh, të kenë tatuazhe apo piercing. Sa u takon meshkujve, nuk mund të mbajnë mjekër apo mustaqe. Përveç kozmetikës, tatuazheve dhe piercing-ëve, është tërësisht e ndaluar të shkosh në shkollë me shapka, sandale, kapela, çanta apo veshje të tjera me simbole politike, qofshin këto foto apo të shkruara.

I vetmi aksesori i lejuar për femrat islame është velloja e tyre, të cilën në shqip e njohim edhe me termin perçe. Edhe pse në dukje është një rregull shumë i mirë i vendosur, kanë nisur kundërshtimet e para kundër presidentit Erdogan.